Analiza dhe rindërtimi nga ana konceptuale i përdorimit të gjuhës së veçantë për përgjigjen ndaj pyetjes se përse një gjendje e caktuar Mjekësore është anormale ose patologjike, përkatësisht përse është sëmundje

Referencat

33. 'GNOSIS' NË MJEKËSI 805
33.1. Tri Kahet e 'Gnosis' në Mjekësi
33.2. Tri Kahet e 'Gnosis' në Mjekësi në 'Historinë Natyrore të Sëmundjes'
33.2.1. 6 (Gjashtë) Fazat apo Etapat e njëpasnjëshme të ecurisë së 'Historisë Natyrore të Sëmundjes'
33.2.2. Etiognosis në 'Historinë Natyrore të Sëmundjes'
33.2.3. Diagnosis në 'Historinë Natyrore të Sëmundjes'
33.2.4. Prognosis në 'Historinë Natyrore të Sëmundjes'
33.3. *Continuum*-i i severitetit klinik (=ashpërsisë klinike) të sëmundjes '*disease*' në natyrë, (bazuar në 'Historinë Natyrore të Sëmundjes') dhe roli i 'Përkufizimit të Rastit'
33.3.1. Individët e sëmurë
33.3.2. *Continuum*-i i severitetit klinik (=ashpërsisë klinike) të sëmundjes '*disease*' në natyrë (=Spektri i Sëmundjes), bazuar në 'Historinë Natyrore të Sëmundjes' dhe 'Përkufizimi i Rastit' ['*Case Definition*']

Referencat

PJESA V – *ETIOGNOSIS* 829

34. GJYKIMI EPIDEMIOLOGJIK MBI SHKAKËSINË 831
34.1. Çfarë është shkakësia?
34.1.1. Sfondi
34.1.2. Modelet e shkakësisë
34.1.3. Faktorët në shkakësi
34.2. Konkluzioni (=konkludimi) shkakësor
34.3. Pamje e idealizuar e procesit shkencor
34.4. Filozofia e konkludimit shkencor — kategoritë filozofike të shkakësisë
34.5. Karl Popper (Popperizmi [*Popperism*])
"Teoria e të Hedhurit Poshtë" ["*Refutability*"]
&
"Teoria e Falsifikimit" ["*Falsifiability*"]
34.6. "Arsyeja e Përbashkët" ["*Common Sense*"]
34.7. Konkluzioni Statistikor dhe Konkluzioni Shkakësor

34.8. Koncepti epidemiologjik i shkakësisë
34.8.1. Koncepti i shkakësisë: Shkaku i Nevojshëm dhe Shkaku i Mjaftueshëm
34.8.2. Koncepti i shkakësisë: Fraksioni Etiologjik
34.8.3. Modeli "Picë" i shkakësisë
34.8.4. Nënteksti (nënkuptimi) i Modelit "Picë" të shkakësisë
34.8.4.1. Shumëshkakësia
34.8.4.2. Shkaqet Gjenetike kundrejt atyre Mjedisore dhe Anasjelltas
34.8.5. Ndërveprimi midis Shkaqeve (Komponentëve Shkakësorë apo Determinantëve/Faktorëve Risk):
Shkaku = Mozaik/Ansambël Komponentësh Shkakësorë
34.8.6. Shuma e Fraksioneve të Atribueshme (= e Komponentëve Shkakësorë)
34.8.7. Koncepti i Shkakësisë: Shkakësia Deterministike kundrejt asaj Probabilistike
34.8.7.1. Shkakësia Deterministike
34.8.7.2. Shkakësia Probabilistike
34.8.8. Koncepti i Shkakësise: Zinxhiri i Shkakësisë
(Shkaku i Shkakut, Shkaku i Shkakut të Shkakut, ...)
(Shkaqet Distale dhe Shkaku Proksimal)
34.9. Asocijimi statistikor dhe gjykimi mbi vlefshmërinë e tij
34.9.1. Roli i Shansit
34.9.2. Roli i Bias-it
34.9.3. Roli i Konfonduesit
34.10. Ndërlidhja Shkak-Efekt (Shkak-Pasojë) dhe Kriteret e Gjykimit të saj
34.10.1. Forca e asocijimit
34.10.2. Besueshmëria biologjike
34.10.3. Qendrueshmëria (konsistenca) me studimet (kërkimet) e tjera
34.10.4. Njëpasnjëshmëria kohore (apo në kohë)
34.10.4.1. Historia Natyrore e Sëmundjes
34.10.4.2. Periudhë-Koha e Induktimit
34.10.4.3. Periudha e Latencës (Periudha latente)
34.10.4.4. Sfidat në praktikë në përcaktimin e qartë të njëpasnjëshmërisë kohore shkak-efekt
34.10.5. Ndërlidhja Dozë-Përgjigje (Dozë-Efekt)
34.10.6. Kthyeshmëria
34.10.7. Skicimi i Studimit Epidemiologjik
34.10.8. Specificiteti
34.10.9. Të gjykuarit e evidencës
34.11. Skema përmbledhëse e interpretimit të shkakësisë në një studimi epidemiologjik
Referencat

35. ETIOGNOZA [*ETIOGNOSIS* (*AETIOGNOSIS*)] dhe
PATOGJENEZA [*PATHOGENESIS*] 903
35.1. 'Etiognoza' ['*Etiognosis*' ('*Aetiognosis*')]
= 'Etiogjeneza' ['*Etiogenesis*' ('*Aetiogenesis*')]
= 'Etiologjia' ['*Etiology*' ('*Aetiology*')]
e Sëmundjes '*Disease*' ('*Illness*')
35.2. 'Gjeneza' ['*Genesis*'] e Sëmundjes — 'Patogjeneza' ['*Patogenesis*']
35.3. Mjekësia Komunitare kundrejt Mjekësisë Klinike në studimin e '*Etiognosis*'
('Etiogjenezës') të Sëmundjes '*Disease*' (apo 'Ngjarjes Shëndetësore' në përgjithësi)
35.3.1. 'Ngjarje Shëndetësore' kundrejt 'Sëmundje' '*Disease*''
35.3.2. Mjekësia Komunitare kundrejt Mjekësisë Klinike në studimin e '*Etiognosis*'
('Etiogjenezës') të Sëmundjes '*Disease*' (apo 'Ngjarjes Shëndetësore')
Referencat

PJESA VI – *DIAGNOSIS* 919

36. DIAGNOZA [*DIAGNOSIS*] 921
36.1. Aspekte të terminologjisë
36.2. Diagnoza dhe Procesi i Diagnostikimit
36.2.1. Çfarë është 'Diagnoza' ['*Diagnosis*']?
36.2.2. Procesi i Diagnostikimit
36.2.3. Vlerësimi pranë shtratit (të pacientit)
36.2.4. Testimi Diagnostik
36.2.5. Vendim-marrja Klinike
36.2.6. Sfidat për Diagnozën
36.3. Diagnoza në Praktikën Mjekësore – Funksionet dhe Problemet
36.3.1. Sfondi
36.3.2. Funksionet (=Rolet) e Diagnostikimit
36.3.3. Gjashtë Probleme në Filozofinë e Diagnozës
Referencat

37. DIAGNOZA KLINIKE [*CLINICAL DIAGNOSIS*] DHE
PERFORMANCA PROFESIONALE E MJEKUT KLINICIST 945
37.1. 'Diagnoza Klinike dhe Interpretimi Shkencor i saj' nga Mjeku i Sotëm Klinicist
(Vështrim Kritik nga Olli S. Miettinen)
37.2. Gjykimi shkencor i mjekut klinicist lidhur me diagnozën klinike
37.3. Teoria e mjekësisë në përditësimin profesional shkencor të mjekut të sotëm

Referencat

38. ETIKA E DIKOTOMISË DIALEKTIKE NË MARRËDHËNIET MJEK-PACIENT 959
38.1. Sfondi
38.2. Aspektet ndikues në Etikën e Mjekësisë:
"Aspekti i Mjekësisë" dhe "Aspekti i Ecurisë së Jetës Individuale"
38.2.1. "Aspekti i Mjekësisë"
38.2.1.1. Disa tipare kryesore të "Aspektit të Mjekësisë"
38.2.1.2. Dimensionet (=përmasat) e ndryshme të "Aspektit të Mjekësisë"
38.2.2. "Aspekti i Ecurisë së Jetës Individuale"
38.2.3. Përdorimi i aspekteve për të rritur komunikimin dhe autonominë e pacientit
38.3. Konkluzione mbi Etikën e Dikotomisë Dialektike në Marrëdhëniet Mjek-Pacient
Referencat

PJESA VII – Përkufizimi i Rastit [*Case Definition*] 979

39. PËRKUFIZIMI I RASTIT [*CASE DEFINITION*].....981
39.1. Rëndësia vendimtare e 'Përkufizimit të Rastit' ['*Case Definition*'] në
Cilësinë, Tejsaktësinë [*Accuracy*] dhe Kohëduhurshmërinë [*Timeliness*]
e Diagnozës Klinike [*Clinical Diagnosis*]
39.2. Rëndësia Vendimtare e 'Përkufizimit Të Rastit' ['*Case Definition*'] në
Cilësinë, Tejsaktësinë [*Accuracy*] dhe Kohëduhurshmërinë [*Timeliness*]
e Survejancës në Shëndetin Publik (=Mjekësinë Komunitare)
39.3. Ndërtimi i një 'Përkufizimi të Rastit'
39.4. Kategoritë e Rasteve:
'Rast i Mundshëm' (='Rast i Suspektuar) ['*Possible Case*' (='*Suspected Case*'],
'Rast i Gjasshëm' ['*Probable Case*'],
'Rast i Konfirmuar' ['*Confirmed Case*']
39.5. 'Gjetja Aktive e Rastit' ['*Active Case Finding*']
39.6. Sensitiviteti kundrejt Specificitetit në "Përkufizimin e Rastit"
39.7. Parimet e përgjithshme për zbatimin e 'Përkufizimit të Rastit'
39.7.1. Kriteret klinike
39.7.2. Kriteret laboratorike
39.7.3. Kriteret epidemiologjike
39.8. 'Përkufizimi i Rastit' është një kategori dialektike që evoluon (ndryshon) me ecurinë
e kohës
Referencat

PJESA VIII – *PROGNOSIS* 995

40. PROGNOZA [*PROGNOSIS*] 997
40.1. Aspekte të terminologjisë
40.2. Çfarë është një prognozë?
40.2.1. Çështje mbi përdorimin e termit 'Prognozë' ['*Prognosis*']
40.2.2. Implikimet e Prognozës
40.2.3. Çfarë është një 'Faktor Prognostik'?
40.2.4. Rezultatet Prognostike kundrejt Rezultateve Parashikuese
40.2.5. (Tej)Saktësia [*Accuracy*] e Prognozës
40.3. Studime mbi Prognozën e Sëmundjes (Ngjarjes Shëndetësore)
40.3.1. Faktorët Risk kundrejt Faktorëve Prognostikë
40.3.2. Elementet e një Studimi Prognostik
40.3.3. Vlerësimi i një Studimi Prognostik
Referencat

41. VËSHTRIM I DETAJUAR MBI STUDIMIN PROGNOSTIK (apo KËRKIMIN PROGNOSTIK apo HULUMTIMIN PROGNOSTIK) 1011
41.1. Sfondi
41.2. Thelbi i Prognozës (Prognostikimit)
41.3. Hulumtimi Prognostik me shumë Variabla (=(Për)Qasja Shumëvariable)
41.4. Përdorimi i Modeleve Prognostike
41.5. Dallimet nga Studimi Etiologjik (apo Kërkimi Etiologjik, apo Hulumtimi Etiologjik)
Referencat

PJESA IX – PARANDALIMI (=PREVENIMI) 1021

42. PARANDALIMI I SËMUNDJES (NGJARJES SHËNDETËSORE) 1023
42.1. Qëllimi i parandalimit
42.2. Pse kërkohet të parandalojmë?
42.2.1. Postulati "Të Parandalosh Është Më Mirë Se Të Mjekosh "
42.2.2. Argumenti ekonomik
42.2.3. Argumenti humanitar kundrejt atij ekonomik
42.3. Parandalimi (=prevenimi) dhe *continuum* i ashpërsisë klinike të sëmundjes

42.4. Llojet (=tipat) e parandalimit lidhur me 'Historinë Natyrore të Sëmundjes'
42.4.1. Përkufizimi i parandalimit (prevenimit) dhe nivelet (llojet, tipat) e parandalimit kundrejt boshtit kohor të "Historisë Natyrore të Sëmundjes"
42.4.2. Parandalimi Primordial
42.4.3. Parandalimi Parësor (=Primar)
42.4.4. Parandalimi Dytësor (=Sekondar)
42.4.5. Parandalimi Tretësor (Terciar)
42.4.6. Parandalimi Katërsor (=Kuaternar)
42.4.7. Parandalimi Katërsor (=Kuaternar) i vështruar si Pjesë Bashkëpunuese dhe njëherësh Përbërëse e Parandalimit Tretësor (=Terciar), Parandalimit Dytësor (=Sekondar), dhe madje edhe Parandalimit Parësor (=Primar)
42.4.7.1. Thelbi
42.4.7.2. Koncepti i Parandalimit Katërsor (=Kuaternar) dhe evoluimi i tij
42.4.7.3. Dëmi i lidhur me Ndërhyrjet Parandaluese Mjekësore
42.4.7.4. Dëmi i lidhur me Ndërhyrjet Mjekësore përtej Ndërhyrjeve Parandaluese
42.4.7.5. Parandalimi Katërsor (=Kuaternar) — Nevoja për një përkufizim të ri
42.5. Spektri i parandalimit
42.6. Konkluzion
Referencat

43. INDIVIDËT DHE POPULLATAT dhe
DY STRATEGJITË KRYESORE TË PARANDALIMIT (=PREVENIMIT) 1055
43.1. Individët dhe Popullatat
43.1.1. Variacioni (=Ndryshimi) Individual
43.1.1.1. Sfondi
43.1.1.2. Determinantët (=Përcaktorët) Gjenetikë të Diversitetit (=Shumëllojshmërisë)
43.1.1.3. Determinantët (=Përcaktorët) Mjedisorë (Socialë dhe të Sjelljes) të Diversitetit (=Shumëllojshmërisë)
43.1.2. Variacioni (=ndryshimi) ndërmjet popullatave
43.1.2.1. Sfondi
43.1.2.2. Diferencat që përfshijnë popullatën si një e tërë
43.1.2.3. Shumica 'Normale' përkufizon (përcakton) çfarë është 'Abnormale' ('Jonormale')
43.1.3. Popullatat 'E Sëmura' dhe 'Të Shëndetshme'
43.2. Strategjia e Parandalimit e-Bazuar-në-Popullatë
43.2.1. Disa implikime (ndërthurje) të ndryshimit të popullatës
43.2.1.1. Sfondi
43.2.1.2. Cili është potenciali për Strategjinë alternative të-Bazuar-në-Popullatë?
43.2.2. Principet e Strategjisë së Parandalimit të-Bazuar-në-Popullatë
43.2.3. Shkaqet Themelore dhe Proksimale
43.2.4. Anët e Forta (Avantazhet) e Strategjisë së Parandalimit të-Bazuar-në-Popullatë

43.2.4.1. Strategjia e Parandalimit e Bazuar-në-Popullatë është Radikale
43.2.4.2. Strategjia e Parandalimit e Bazuar-në-Popullatë është E Fuqishme
43.2.4.3. Strategjia e Parandalimit e Bazuar-në-Popullatë është E Përshtatshme (=është strategjia E Duhur)
43.2.5. Kufizimet (Disavantazhet) dhe Problemet e Strategjisë së Parandalimit të-Bazuar-në-Popullatë
43.2.5.1. Pranueshmëria
43.2.5.2. Realizueshmëria (Fizibiliteti/Performanca)
43.2.5.3. Shpenzimet (Kostot) dhe Siguria
43.3. Parandalimi për Individët dhe Strategjia e Parandalimit e-Bazuar-në-Grupet-në-Risk-të-Lartë
43.3.1. Individi – Përqasja e Përqendruar-tek-Individi
43.3.2. Parandalimi dhe Mjekësia Klinike (=Kujdesi Klinik)
43.3.3. Motivimi për Strategjinë e Parandalimit në Grupet në-Risk-të-Lartë
43.3.4. Identifikimi i Riskut — Depistimi (Skriningu)
43.3.4.1. Sfondi
43.3.4.2. Udhëzimet e Politikave për Depistimin (Skriningun) në Vlerësimin e Riskut
43.3.5. Avantazhet (Anët e Forta) të Strategjisë Parandaluese të Bazuar në-Grupet-në-Risk-të-Lartë
43.3.5.1. Ndërhyrja është e përshtatshme për individin
43.3.5.2. Kjo qasje shmang interferimin me ata individë që nuk janë në risk të lartë ndaj faktorëve specifikë risk
43.3.5.3. Kjo qasje akomodohet lehtësisht me etosin (=karakterin individual) dhe organizimin e kujdesit mjekësor
43.3.5.4. Kjo qasje ofron një përdorim kosto-efektiv të burimeve
43.3.5.5. Selektiviteti (përzgjedhja) përmirëson raportin përfitim (dobi)-kundrejt-riskut
43.3.6. Disavantazhet (Anët e Dobëta) të Strategjisë Parandaluese të Bazuar në-Grupet-në-Risk-të-Lartë
43.3.6.1. Parandalimi medikalizohet (=bëhet mjekësor)
43.3.6.2. Suksesi është vetëm paliativ dhe i përkohshëm
43.3.6.3. Strategjia është jo-adekuate nga këndvështrimi i sjelljes (=strategji sjellore jo-adekuate)
43.3.6.4. Kufizohet nga një aftësi e dobët për të parashikuar të ardhmen e individëve
43.3.6.5. Kontributi në kontrollin e përgjithshëm të sëmundjes 'disease' mund të jetë zhgënjyeshmërisht i vogël
Referencat

44. SKRININGU (=DEPISTIMI, =SKRINIMI) 1083
44.1. Sfondi

44.2. Sëmundjet e përshtatshme për Depistim (Skrining)
44.3. Testet e Skrining (Depistimit)
44.4. Vlerësimi i Programeve Skrining — Realizueshmëria (Zbatueshmëria, Fizibiliteti) dhe Efikasiteti-Efektiviteti-Efiçienca
44.4.1. Realizueshmëria (Zbatueshmëria, Fizibiliteti)
44.4.2. Ndërlidhjet ndërmjet Prevalencës, Sensitivitetit, Specificitetit dhe Vleres Parashikuese Pozitive PV+
44.4.3. Efikasiteti-Efektiviteti dhe Efiçienca
44.4.3.1. Dallimet kuptimore në terminogjinë e termave Efikasitet, Efektivitet dhe Efiçiencë (=Kosto-Efektivitet) të një Programi Depistimi (Skriningu)
44.4.3.2. Efikasiteti dhe Efektiviteti i një Programi Depistimi (Skriningu)
Referencat

45. SKRININGU (=DEPISTIMI, =SKRINIMI) NË SHËNDETIN PUBLIK (=MJEKËSINË KOMUNITARE, =MJEKËSINË PARANDALUESE) DHE MJEKËSINË KLINIKE 1113
45.1. Sfondi
45.2. Dallimet dhe Ngjashmëritë e Skriningut në Shëndetin Publik (=Mjekësinë Komunitare, =Mjekësinë Parandaluese) dhe në Mjekësinë Klinike
45.2.1. Karakteristikat e përbashkëta – Çfarë është dhe çfarë nuk është Depistim
45.2.2. Programet e Depistimit kundrejt Testeve të Depistimit Sistematik — Sistematikja kundrejt *Ad Hoc*
45.2.3. Mjedisi i depistimit, kush e fillon depistimin dhe kush pritet të përfitojë
45.2.4. Faza e 'Historisë Natyrore të Sëmundjes'
45.2.5. Llojet e Skriningut (=Depisrimit, =Skrinimit)
45.2.6. Survejanca (kundrejt Depistimit / Skriningut)
Referencat

46. PROMOVIMI dhe MBROJTJA E SHËNDETIT në NIVEL KOMUNITAR (=SHËNDETI PUBLIK) dhe në NIVEL INDIVIDUAL (=MJEKËSIA KLINIKE) — DY (PËR)QASJE NDËRVEPRUESE DHE NDËRPËRPLOTËSUESE 1127
46.1. Sfond i Parashtrimit në Kapituj Paraprirës i një Strategjie Dikotomike Parandalimi dhe i një (Për)Qasjeje Dikotomike Trajtimi
46.1.1. Komuniteti (Popullata) dhe Individi në lidhje me Parandalimin (=Prevenimin)
46.1.2. Dy (Për)Qasjet e trajtimit të Individit-Pacient në Mjekësinë Klinike
46.1.2.1. Sfondi
46.1.2.2. Karakteristikat e Secilës Qasje
46.1.2.3. Avantazhet (Anët Pozitive) e Secilës Qasje

46.1.2.4. Disavantazhet (Anët Negative) e Secilës Qasje
46.1.2.5. Cila Qasje duhet të ketë përparësi?
46.1.2.6. Përfundim
46.2. Promovimi dhe Mbrojtja e Shëndetit në Nivel Komunitar (=Shëndeti Publik) dhe në Nivel Individual (=Mjekësia Klinike) — Dy (Për)Qasje Ndërvepruese dhe Ndërpërplotësuese
46.2.1. Promovimi i Shëndetit dhe Mbrojtja e Shëndetit në Nivel Komunitar (=Shëndeti Publik), (=Mjekësia Komunitare), (=Mjekësia Parandaluese)
46.2.1.1. (Për)Qasja
46.2.1.2. Komuniteti / Popullata
46.2.1.3. Promovimi i Shëndetit
46.2.1.4. Mbrojtja e Shëndetit
46.2.1.5. Parandalimi i Sëmundjeve '*Disease*'
46.2.1.6. Sfidat dhe Mundësitë
46.2.2. Promovimi (Edukimi) i Shëndetit dhe Mbrojtja e Shëndetit në Nivel Individual: = Individi-Pacient (=Mjekësia Klinike) apo =Angazhimi i Pacientit
46.2.2.1. Çfarë është (Për)Qasja e Promovimit (Edukimit) dhe Mbrojtjes së Shëndetit e Bazuar-te-Pacienti (=Angazhimi i Pacientit)?
46.2.2.2. Angazhimi i Pacientit
46.2.2.2.1. Thelbi
46.2.2.2.2. Fushat për Angazhimin e Pacientit
46.2.2.2.3. Faktorët që ndikojnë në Angazhimin e Pacientit
46.2.2.2.4. Zgjidhje të mundshme
46.2.2.2.5. Hapat praktikë të ardhshëm
Referencat

CV e autorit (shqip & anglisht) 1155

MBI AUDIENCËN E LIBRIT "SHËNDETI DHE SËMUNDJA — VËSHTRIM GJITHËPËRFSHIRËS FILOZOFIK DHE EPIDEMIOLOGJIK"

Ky punim shkencor voluminoz (rreth 1.200 faqe format 200x280 mm, 46 kapituj në total), sikurse shihet në titullin e tij "Shëndeti dhe Sëmundja — Vështrim Gjithëpërfshirës Filozofik dhe Epidemiologjik", është për një audiencë të specializuar.

Konkretisht, e konsideroj atë me vlerë në radhë të parë për Mjekët (pavarësisht nga fusha/nënfusha e profesionalizimit dhe/ose angazhimit të tyre pasuniversitar).

Krahas Mjekëve, gjykoj që punimi është i përshtatshëm edhe për kategori të tjera të audiencës pasuniversitare, konkretisht:

- Specialistët e Shëndetit Publik;
- Biologët;
- Stomatologët;
- Punonjësit Socialë;
- Sociologët;
- Psikologët;
- Specialistët Pasuniversitarë të profileve "Infermieri" dhe "Mami".

Megjithatë, eksperienca ime kohë-gjatë didaktike në mësimdhënien universitare dhe në kërkimin shkencor më dikton përshtatshmërinë e punimit edhe për:

- Studentët e Vitit të Fundit (Viti VI) të Degës "Mjekësi"
  (Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës)
- Studentët e Vitit të Fundit (Viti II) të 'Master Shkencor" të Degës "Shëndet Publik"
- (Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës).

Gjykimin e mësipërm e përligj PËRMBAJTJA E LËNDËS (Shih!).

Autori

Prof. Dr. EDUARD KAKARRIQI

Tiranë, 2025

PËRMBLEDHJE

"FOKUSI TE SHËNDETI APO TE SËMUNDJA?" (RAPORTET E SHËNDETIT PUBLIK APO MJEKËSISË KOMUNITARE ME MJEKËSINË KLINIKE)

Pyetja **"Fokusi te shëndeti apo te sëmundja?"** e merr nismën e vet në dy 'mbretëritë' e mjekësisë: **mjekësia komunitare (apo shëndeti publik apo mjekësia parandaluese (=preventive))** dhe **mjekësia klinike**. Ndërsa në mjekësinë klinike aktori është klinicisti dhe klient i tij është individi-pacient, në mjekësinë komunitare është epidemiologu dhe klient i tij është komuniteti, dmth popullata, *e kuptuar jo si shumatorja numerike e vetëm individëve-pacientë, por si shumatorja e të gjithë individëve përbërës të komunitetit apo popullatës – të shëndetshëm dhe të sëmurë*.

Kjo është një pyetje, përgjigja ndaj së cilës do të ngërthente në thelb pyetje të tilla si
"Ç'është shëndeti dhe çdo të thotë 'i shëndetshëm' dhe "Ç'është sëmundja dhe çdo të thotë 'i sëmurë' në lidhje me '***historinë natyrore të sëmundjes***'?";
"Ç'është mjekësia komunitare (apo shëndeti publik) dhe ajo klinike dhe cili është raporti ndërmjet tyre: kundershtí apo ndërveprim?";
"Cili është procesi i njohjes ('***gnosis***') në shëndetin publik (mjekësinë komunitare) dhe mjekësinë klinike lidhur me etiologjinë apo shkakësinë ('***etiognosis***'), diagnozën ('***diagnosis***'), dhe prognozën ('***prognosis***')?"; si dhe
"Ç'është **parandalimi** lidhur me '*historinë natyrore të sëmundjes*' dhe cili është raporti i tij me shëndetin publik (mjekësinë komunitare) dhe mjekësinë klinike?".
Pyetje këto, që faktikisht shprehin raportet e promocionit shëndetësor dhe profilaksisë të mjekësisë komunitare, dmth shëndetit publik, ndaj diagnostikimit dhe trajtimit (mjekimit, kurimit) të mjekësisë klinike, dhe e kundërta.

Dhe janë pikërisht koncepti i termit "sëmundje" në kuptimin sëmundje ***'sicknes'***, sëmundje ***'disease'*** dhe sëmundje ***'illness'*** (një term i vetëm në gjuhën shqipe dhe/edhe gjuhët neolatine kundrejt tre termave anglosaksonë kuptimndryshëm), **koncepti i '*historisë natyrore të sëmundjes*'**, **koncepti i "*'continuum*-it*' të sëmundjes *'disease'* në natyrë**, si dhe **koncepti i '*epidemiologjisë dhe ai i shkakësisë në epidemiologji*'**, ata, që do të përbënin bazamentin shkencor të përgjigjes ndaj pyetjes bazë dhe pyetjeve rrjedhuese të mësipërme.

Bazuar në '**historinë natyrore të sëmundjes**', **sëmundja** ***'sickness'*** paraqet shtrirjen më të gjerë kohore në boshtin e ecurisë së kohës **t** ***[time]***, në të cilën përfshihen ***'predikamenti*** apo ***parathënia'***

e sëmundjes *'disease'* plus **sëmundja *'disease'***, që nga ana e vet përfshin **sëmundjen *'illness'***. Sëmundja *'disease'* janë çrregullimet anatomike (morfologjike), biokimike, fiziologjike, dhe/ose psikologjike, që instalohen dhe zhvillohen në organizmin human si rrjedhojë e veprimit (impaktit) të shkakut përkatës, dmth ansamblit (tërësisë) të faktorëve (determinantëve) risk përkatës në një moment kohe '**t0**' të 'historisë natyrore të sëmundjes' në ecurinë e kohës '**t**', realizimi i të cilit veprim u mundësua nga ***'predikamenti apo parathënia'*** sociale, psikologjike dhe ekonomike e vendosjes së individit-pacient në mjedisin e vet rrethues. Është pikërisht **sëmundja *'disease'*,** apo ndryshe ***'çrregullimi i shenjuar (i targetuar)'*** (term ky më i saktë), ajo, që, lidhur me etiologjinë, patogjenezën, tablonë apo paraqitjen klinike, menaxhimin terapeutik dhe prognozën, shtjellohet në tekstet mësimore në mënyrë të qartë-përcaktuar.
Ndërkaq, **sëmundja *'illness'***, pjesë përbërëse e sëmundjes *'disease'* në 'historinë natyrore të sëmundjes' në ecurinë e kohës '**t**', nuk është tjetër veçse manifestueshmëria klinike e *'çrregullimit të shenjuar'* anatomik-biokimik-fiziologjik-psikologjik, dmth e sëmundjes *'disease'* në një moment pasardhës kohor '**t1**', me grumbullin e simptomave klinike dhe shenjave klinike, që, së bashku me testet përkatëse laboratorike, pasqyrojnë '**përkufizimin e rastit**' të sëmundjes *'disease'*, mbi të cilin bazohet diagnoza klinike, pra *'diagnosis'* e *modus operandi* të mjekut klinicist.

Por, duhet pasur gjithmonë në konsideratë që, për natyrën nuk ekziston ndarja '**i sëmurë'/'jo i sëmurë'** lidhur me çdo sëmundje *'disease'*. **Në natyrë sëmundja *'disease'* paraqitet me një continuum (vijueshmëri të pandërprerë) të severitetit (ashpërsisë) të saj.** Ndarja kategorike dikotomike (binomiale) 'i sëmurë' dhe 'jo i sëmurë' me sëmundjen *'disease'* të interesit është bërë me konvencion (marrëveshje) pikërisht nga mjekësia klinike, sepse pa të tillë ndarje ajo nuk do të mund të operonte. Dhe, rrjedhimisht, '**përkufizimi i rastit**' ***['case definition']***, dmth ai takëm (set) i simptomave dhe shenjave klinike dhe testeve diagnostikuese përkatëse për çdo sëmundje *'disease'* të **Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve** [***International Classification of Diseases* – ICD**] është fund e krye konvencional. Pa **përkufizimin e rastit** nuk mund të realizohet **diagnosis** në momentin **t1** të historisë natyrore të sëmundjes (ku **sëmundja *'disease'*** manifestohet klinikisht me **sëmundjen *'illness'***). Është një moment me rëndësi kruciale në mjekësinë klinike, por po me të njëjtën rëndësi në këndvështrimin epidemiologjik, sepse mangësitë sasiore dhe të metat cilësore të tij cënojnë drejtpërdrejt të dhënat e survejancës epidemiologjike.

Ilustrimin më të spikatshëm e jep **fusha e sëmundjeve infektive**, ku është i mirënjohur **postulati** "***infeksioni është i ndryshëm nga sëmundja***", dmth "jo çdo i infektuar sëmuret". Konkretisht, *raporti infeksion/sëmundje* (=infeksion/*'illness'*) për çdo sëmundje *'disease'* nuk është asnjëherë 1/1 (me përjashtim vetëm të fruthit), por së paku 2/1, për të arritur në 5/1 apo 20/1 (për shembull, rubeola), 100/1 (për shembull, kolera), apo dhe 1000/1 (për shembull, poliomieliti paralitik), çka do të thotë se për mjekësinë klinike, individi me sëmundjen *'disease'* të interesit por pa sëmundjen *'illness'*, është jo i sëmurë *[ill]*, ndërkohë që për natyrën ai është i sëmurë me sëmundjen *'disease'*.

Situata është e njëjtë në sëmundjet jo-infektive kronike, në sëmundjet neoplazike, në sëmundjet mendore, pra në të gjitha sëmundjet *'disease'*. *Infarkti i miokardit* ka në substratin e vet sëmundjen koronare të zemrës, por vetë *sëmundja koronare e zemrës* nuk përfundon domosdoshmërisht me infarkt miokardi. *Sëmundjet neoplazike* (*kanceri*) kanë në substratin e tyre ndryshimet fillestare në

nivel subqelizor, por vetëm në një proporcion të rasteve këto ndryshime përshkallëzohen në nivel qelizor. Tek çdo individ gjen një dozë *psikopatie*, por ai nuk mund kurrsesi të etiketohet si i sëmurë mendor.

Theksojmë në parantezë që termi më i saktë nga ana shkencore dhe e përgjithësimit do të ishte '**ngjarje shëndetësore**' (që përfshin edhe 'gjendjen shëndetësore') kundrejt atij '**sëmundje**'. Aksidenti apo trauma apo helmimi është 'ngjarje shëndetësore' dhe jo 'sëmundje'. *Vdekja* është absolutisht '*ngjarje shëndetësore*'. **Çka do të thotë se çdo '*sëmundje*' është thelbësisht '*ngjarje shëndetësore*', por jo të gjitha '*ngjarjet shëndetësore*' janë '*sëmundje*'.** Megjithatë, është termi '*sëmundje*' ai, që praktikisht ka marrë pronësinë e përdorimit "*divulgativ shkencor*".

*'**Gnosis**'* (=***njohja***) është thelbësorja në të dy mbretëritë e mjekësisë, mjekësinë klinike dhe mjekësinë komunitare apo shëndetin publik. Ajo është një **kategori kryekeput probabilitare**, **sepse bazohet në një tërësi asnjëherë të plotë të fakteve**. Dhe, kur flasim për *'gnosis'* nënkuptojmë të tre kahet e saj – '***etiognosis***', '***diagnosis***', dhe '***prognosis***'.

'***Diagnosis***' është pikërisht diagnoza (bazuar në *përkufizimin e rastit*) e sëmundjes *'disease'* në momentin e manifestueshmërisë klinike *'illness'* të saj në momentin **t1** të '*historisë natyrore të sëmundjes*'. Përsërisim rëndësinë e saktësisë të saj njëherësh për mjekësinë klinike (diagnoza e saktë për individin-pacient) dhe për mjekësinë komunitare (përcaktimi i saktë epidemiologjik i peshës specifike të sëmundjes së interesit në popullatë).

'***Prognosis***' lidhet me ecurinë e sëmundjes nga **t1** deri në përfundimin e saj (shërim në rastin më të mirë dhe vdekje në rastin më të keq) në momentin pasues kohor **t2** të '*historisë natyrore të sëmundjes*'. Në mjekësinë klinike *prognosis* (*prognoza*) lidhet me trajtimin (mjekimin), pra *cilësinë e kujdesit mjekësor*, ndërkohë që në mjekësinë komunitare apo shëndetin publik, spektri i *prognosis* zgjerohet shumë më tepër sepse nënkupton të ardhmen e ecurisë të sëmundjes së interesit në komunitet/popullatë, parashikim të cilin e realizon kërkimi epidemiologjik.

Ndërkaq, '***etiognosis***' është thuajse tërësisht "*pronë*" e *mjekësisë komunitare*: një ndër drejtimet kryesore të epidemiologjisë është studimi i shkakësisë, përcaktimi i ndërlidhjes ndërmjet shkakut dhe sëmundjes së interesit, *me synim përfundimtar ndërhyrjen për kontroll e parandalim (prevenim)*.

Individi jeton dhe e zhvillon aktivitetin e vet jetësor në mikro- dhe makro-mjedisin fizik, kimik, biologjik, dhe shoqëror që e rrethon atë. Ky mjedis mbart një gamë tepër të gjerë dhe të larmishme faktorësh fizikë, kimikë, biologjikë, e shoqërorë, të cilët veprojnë mbi individin duke përcaktuar (determinuar) rrezikun (riskun) e instalimit të shëndetit të sëmurë (sëmundjes) në të. Ndërkohë, vetë individi mbart veçoritë apo specifikat e mënyrës së tij të të sjellurit, të vepruarit e të jetuarit në mjedisin rrethues, që po ashtu mund të veprojnë tek ai si determinantë risk të sëmundjes. Kemi pra **faktorët apo determinantët risk** mjedisorë dhe ata individualë si dhe individin mbi të cilin ata

veprojnë. Kemi po ashtu **rrjedhojën shëndetësore** të këtij veprimi, e karakterizuar me dëmtimet përkatëse organike (pat-morfologjike), fiziologjike (fiz-patologjike) dhe/ose psikologjike (psiqike), që në një moment kohe (orë, ditë, muaj, apo vite) më pas bëhen ose nuk bëhen (sipas gjasës) të dukshme, të kapshme përmes shenjave dhe simptomave klinike përkatëse.

Lidhur me **shkakësinë**, duhet pasur gjithmonë në konsideratë kompleksiteti i saj:
(i) faktorë biologjikë dhe të sjelljes, (ii) faktorë mjedisorë; (iii) faktorë imunologjikë, (iv) faktorë nutricionalë (të të ushqyerit), (v) faktorë gjenetikë, (vi) faktorë socialë, ekonomikë, shpirtërorë, si dhe (vii) faktorë që lidhen me shërbimet shëndetësore dhe/edhe sociale (disponueshmëria, aksesi, cilësia, etj).
Apo, sipas një tjetër këndvështrimi klasifikues: (i) faktorë predispozues (si mosha, gjinia, sëmundja e mëparëshme), (ii) faktorë mundësues (si të ardhurat, të ushqyerit, strehimi, disponueshmëria e kujdesit mjekësor), (iii) faktorë precipitues (si ekspozimi ndaj një sëmundje të caktuar apo një agjenti toksik të caktuar), dhe (iv) faktorë përforcues (si ekspozimi i përsëritur, lloji i punës, privimi).
Shtjellimi i detajuar mbi shkakësinë tregon që: (i) asnjëherë nuk është një shkak i vetëm (=komponent shkakësor i vetëm, determinant/faktor risk i vetëm) ai, që, qoftë edhe shkak i nevojshëm, të jetë i aftë të shkaktojë i vetëm efektin (=rrjedhojën, sëmundjen) e interesit; (ii) shkaku i nevojshëm është komponent përbërës i shkakut të mjaftueshëm; dhe (iii) shkaku i mjaftueshëm është një **mozaik komponentësh shkakësorë, të nevojshëm dhe të panevojshëm, që veprojnë së bashku në ansambël (=si një e tërë) dhe në ndërveprim me njëri tjetrin**. Por nuk është vetëm ndërveprim. Madje, **ndërveprimi është vetëm forma**. Ndërkohë që **përmbajtja është 'koncepti i zinxhirit të shkakësisë'**.

Epidemiologjia, (biostatistika e nënkuptuar si komponent inherent i saj), është shkenca bazë e shëndetit publik. Rrjedhimisht, **si shkencë e mjekësisë komunitare, epidemiologjia fokusohet pikërisht në grupin-komunitetin-popullatën** duke injoruar veçantitë e individit. Ajo bazohet **së pari,** në atë që **sëmundja në popullatë nuk ndodh rastësisht**, dhe, **së dyti**, në atë që **sëmundja ka faktorë shkakësorë dhe faktorë preventivë (parandalues)**, të cilët mund dhe duhet të identifikohen përmes kërkimit sistematik të popullatave të ndryshme apo grupeve të individëve brenda një popullate në vende të ndryshme ose në kohë të ndryshme. E fokusuar në popullatë dhe e bazuar në keto dy koncepte, **epidemiologjia studion sëmundjen (ngjarjen shëndetësore në kuptimin e përgjithshëm) në popullatë lidhur me shpërndarjen, frekuencën e hasjes dhe determinantët risk të saj, dhe aplikon këtë studim për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjes**.

Është plotësisht i kuptueshëm roli krucial i epidemiologjisë në mjekësinë komunitare, dmth në procesin e shëndetit publik, ku ajo përbën boshtin shkencor. Por cili është roli i epidemiologjisë në mjekësinë klinike?

Në praktikën e vet klinike, klinicisti përballet me diagnozën dhe menaxhimin e pacientit, dhe historikisht ka menduar se ai në thelb praktikon **"artin dhe shkencën e mjekësisë klinike"**; ("arti" bazohet në të atillë elementë si bindja, gjykimi dhe intuita jonë, të cilët janë të pashpjegueshëm prej

nesh, ndërsa "shkenca" bazohet në njohjen *['gnosis']*, llogjikën dhe përvojën tonë, elementë këta të shpjegueshëm prej nesh). Por, ndodhitë dhe kërkesat në praktikën klinike, të hasura në kohë të ndryshme dhe në situata të ndryshme, arritën dora-dorës ta ndërgjegjësojnë mjekun klinicist mbi nevojën e aplikimit në praktikën klinike të **"epidemiologjisë së orientuar klinikisht" apo "epidemiologjisë klinike"**, si një ndër shkencat bazë për interpretimin e dukurive klinike, deri sa u plotkuptua përfundimisht prej tij domosdoshmëria e kombinimit të mjekësisë klinike me epidemiologjinë klinike. Njohja prej klinicistit e principeve të epidemiologjisë dhe aplikimi i tyre ndaj bindjeve, gjykimeve dhe intuitave, që përbëjnë "artin" e mjekësisë, i realizon klinicistit në praktikën e vet klinike me individin-pacient përmirësimin thelbësor të saktësisë dhe efiçiencës së diagnozës dhe prognozës si dhe efektivitetin e menaxhimit. **Teza, që epidemiologjia përbën shkencën bazë të mjekësisë parandaluese (preventive), u shtri edhe në mjekësinë klinike (kurative)** duke argumentuar përfundimisht atë, që **epidemiologjia është "shkenca e artit të mjekësisë"**.

Gjendja jonë natyrore është shëndeti i mirë. Por, "sëmundja *'sickness'* ndihet, kurse shëndeti aspak" thotë një proverb i lashtë kinez. Rrjedhimisht, shëndeti ka marrë një vëmendje më pak filozofike sesa sëmundja *'disease'*. Terreni konceptual në rastin e shëndetit është pak më kompleks se ai i sëmundjes. Pikërisht me këtë terren lidhet përkufizimi aktual i shëndetit. **Organizata Botërore e Shëndetësisë** e përkufizon shëndetin si **"një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale (shoqërore) dhe jo thjesht e mungesës të sëmundjës** [*disease*]**, duke qenë një e drejtë thelbësore e çdo njeriu (barazia në shëndet)."** Ndonëse ky përkufizim i OBSH ka qenë kritikuar për shkak të vështirësisë në përkufizimin dhe matjen e cilësorit (mbiemrit cilësor) "e plotë" për emrin "mirëqenie", ai thelbësisht nënkupton atë, që **"shëndeti është një gjendje, që karakterizohet nga integritet anatomik, fiziologjik dhe psikologjik i individit; aftësi e individit për të performuar (zbatuar në praktikë) vlerat, normat morale dhe rolin e familjes, komunitetit dhe shoqërisë; aftësi e individit për të përballuar stresin fizik, biologjik, psikologjik dhe social; një ndjenjë e mirëqenies; dhe, së fundi, liri nga risku i sëmundjes *'disease'* dhe vdekjes së parakohëshme."**

Pra, shëndeti është një koncept kompleks. Do të thotë që **të njejtin kompleksitet paraqet fusha e Shëndetit Publik:** në Shëndetin Publik ndërthuren me *mjekësinë* disiplina të ndryshme si *biologjia*, *sociologjia*, *psikologjia*, *ekonomia*, *bujqësia e veterinaria*, *arsimi*, *kultura*, *ruajtja e mjedisit*, etj, duke pasur si metodë bazë operimi *epidemiologjinë* (*biostatistika* e nënkuptuar në mënyrë implicite si pjesë integrale e epidemiologjisë). Do të thotë që **modeli mjekësor i shëndetit** nuk mund të kuptohet i shkëputur nga **modeli social i shëndetit**: ata ndërthuren në vend që të kontrastojnë.

Konkretisht, **modeli mjekësor i shëndetit** konsiston në atë, që: (i) fokusi është sëmundja *'disease'*, e konsideruar si e kundërta e shëndetit; (ii) mjekësia klinike apo diagnoza dhe mjekimi i individit të sëmurë është ajo, që nënkupton parandalimin (prevenimin) tretësor, dmth cilësinë e kujdesit shëndetësor; dhe (iii) shëndeti publik apo mjekësia komunitare është ajo, që realizon diagnozën e komunitetit dhe parandalimin (prevenimin) parësor e dytësor, duke pasur në thelb studimin e shkakësisë (lidhja shkak-pasojë) mbi bazën e shkakut (ansambël faktorësh apo determinantësh risk) proksimal në kuptimin e lidhjes shkak proksimal-sëmundja përkatëse. Kurse **modeli social i**

shëndetit konsiston në atë, që: (i) shëndeti është rrjedhojë e efekteve të të gjithë faktorëve me impakt mbi individin, familjen, komunitetin, përmes mënyrave e rrugëve të ndryshme; (ii) dmth studimi i shkakësisë shtrihet në **'konceptin e zinxhirit të shkakësisë'** – "shkak i shkakut", "shkak i shkakut të shkakut", ..., apo në mënyrë të përgjithshme një zinxhir shkaqesh tanimë distalë (secili shkak i konsideruar gjithmonë si ansambël faktorësh apo determinantësh risk), ku përfundimi është shkaku proksimal i lidhur drejtpërdrejt me sëmundjen apo shëndetin e sëmurë.

Qëllimet bazale të mjekësisë janë (i) të promovojë shëndetin, (ii) të ruajë shëndetin, (iii) të restaurojë (përtërijë) shëndetin kur ai është i dëmtuar, dhe (iv) të minimizojë vuajtjen trupore dhe/ose mendore. Këto qëllime bazale janë të trupëzuara (të përfshira) në termin **'parandalim (prevenim)'**. Parandalimi (prevenimi) përfaqëson momentin thelbësor të filozofisë së mjekësisë, shprehur sintetikisht në **postulatin "*më mirë të parandalosh se të mjekosh*".** Gjerësia e konceptit 'parandalim (prevenim)' dhe e drejtimeve të ndërhyrjes (intervenimit) për realizimin e tij shpjegon larmishmërinë e modeleve, përqasjeve dhe strategjive të këtij proçesi. Veçse të kuptuarit shkencërisht të tij kërkon si kusht *sine qua non*: (i) të bazuarit e parandalimit në konceptin e 'historisë natyrore të sëmundjes'; (ii) të bazuarit e parandalimit në konceptin e gjerë të *shkakësisë*; dhe (iii) të bazuarit e parandalimit në konceptin e gjithëpërfshirjes (individi-komuniteti-dhe mbarë shoqëria si aktorë), udhëhequr nga **principi filozofik dostojevskian "*Ne jemi të gjithë përgjegjës për gjithçka*"** (**Dostojevskij**).

Parandalimi do të përkufizohej si aksionet/ndërhyrjet e ndërmarra që synojnë në çrrënjosjen (eradikimin), eliminimin apo minimizimin e impaktit të sëmundjes *'disease'* dhe paaftësisë, apo, nëse asnjera prej këtyre nuk do të ishte e mundshme, atëhere synimi do të drejtohej në të vonuarit e progresit të semundjes *'disease'* dhe paaftësisë. Koncepti i parandalimit përkufizohet apo përcaktohet më mirë në kontekstin e niveleve të tij, tradicionalisht atij parësor, dytësor, tretësor (dhe/edhe ai katërsor), si dhe pararendësit të tyre – parandalimit primordial.

Parandalimi primordial konsiston në ndërhyrjet, aksionet, masat që ndërmerren për të frenuar shfaqjen apo zhvillimin e faktorëve (determinantëve) risk, përbërës të ansamblit shkak, faktorë këta të natyrës mjedisore (biologjike, fizike, kimike), ekonomike, sociale, të sjelljes dhe stilit të jetës, etj. Pra, ndërmerret para instalimit të fazës *'predikament* apo *parathënie'* (pjesa fillestare e sëmundjes *'sickness'* në 'historinë natyrore të sëmundjes'), përfaqësohet nga edukimi individual dhe komunitar dhe **është objekt operimi i vetëm shëndetit publik apo mjekësisë komunitare**.

Parandalimi parësor (**primar**) do të përkufizohej si aksioni apo ndërhyrja që ndërmerret para shpërthimit të sëmundjes *'disease'*, pra para fillimit në organizëm të ndryshimeve specifike morfologjike, biologjike, fiziologjike apo/dhe psikologjike që lidhen me sëmundjen *'disease'* përkatëse, dhe nënkupton ndërhyrjen në fazën e para-patogjenezës së saj, me synim pamundësimin e plotë të hasjes apo fillesës të sëmundjes. **Ai është objekt operimi kryesisht i shëndetit publik apo mjekësisë komunitare, por pa përjashtuar në raste të caktuara edhe mjekësinë klinike**, dhe konsiston në "promocionin shëndetësor", konkretisht edukimi shëndetësor, modifikimet mjedisore, ndërhyrjet nutricionale apo të të ushqyerit, ndryshimet e sjelljes dhe stilit të jetës, si dhe në "mbrojtjen specifike", konkretisht vaskinimi, kemoprofilaksia, përdorimi i ushqyesëve dhe suplementëve

specifikë, mbrojtja kundrejt dëmtuesëve okupacionalë, siguria ushqimore, kontrolli i dëmtuesëve mjedisorë (ndotja e ajrit, etj).

Parandalimi dytësor (**sekondar**) përkufizohet si aksioni/ndërhyrja që ndërmerret për të ndalur progresin e sëmundjes *'disease'* kah zhvillimit të saj në manifestueshmëri klinike (=sëmundja *'illness'*) me shenjat dhe simptomat klinike përkatëse dhe provat/testet laboratorike përkatëse (='përkufizimi i rastit'). Ai konsiston në diagnozën e herëshme (testet e skrinimit apo depistimit) dhe trajtimin adekuat dhe **është objekt operimi njëherësh i shëndetit publik apo mjekësisë komunitare dhe mjekësisë klinike, në ndërveprim midis tyre**.

Parandalimi tretësor (**terciar**) realizohet në atë stad të 'historisë natyrore' të sëmundjes *'disease'*, kur ajo është bërë tanimë e manifestueshme klinikisht (=*'illness'*) dhe konsiston pikërisht në cilësinë e kujdesit mjekësor për të realizuar shërimin dhe shmangur apo minimizuar paaftësinë, **duke u paraqitur kështu objekt operimi i vetëm mjekësise klinike**.

Parandalimi katërsor (**kuaternar**), me **postulatin e tij bazë "*primum non nocere*"**, përkufizohet si "ndërhyrja, veprimi, aksioni i ndërmarrë për të mbrojtur individët (personat e shëndetshëm / pacientët) nga ndërhyrjet mjekësore që mund të shkaktojnë më shumë dëm sesa të mirë, për të identifikuar pacientin në risk të mbi-medikalizimit (mbi-mjekimit), për ta mbrojtur atë nga invadimi i barnave të reja dhe për t'i sugjeruar atij ndërhyrje që janë të pranueshme nga ana etike".

